

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Edukimit - Parafillor</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Bazat e hulumtimit ne edukim</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bechelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>IV-semestri i -VIII</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Ligjëratë 14 : 00 - 15 : 30</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.ass.dr.Shemsi Morina</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>shemsi.morina@uni-prizren.com</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Kursi do të ekzspozojë studentët ndaj hapave konkret të realizimit të një problem të hulumtimi duke filluar nga definimi i problemit deri tek mbledhja e të dhënave, analiza dhe raportimi i të dhënave. Rëndësi do t’i kushtohet edhe formatit të raporteve të hulumtimit si dhe formatit të projektpropozimeve,gjate punes kerkimore-shkencore.Kursi Metodologji e hulumtimit shkencor ka për synim t’i aftësojë studentët për teorinë dhe teknikat e hulumtimit akademik, ku do të përfshihen ligjërata dhe diskutime për fazat e procesit hulumtues shkencor, siç mund të jenë: zgjedhjet e temave, hipotezat, mbledhja e materialit shkencor, shkrimi i tekstit akademik, struktura e tekstit, diskursi akademik, format e civateve dhe referencave,si dhe përgatitja përfundimtare për botimin e punimit shkencor etj.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Synimi i kursit Metodologji e hulumtimit shkencor është që t’ua qartësojë studentëve konceptet dhe teknikat e punës shkencore si në rrafshin teorik ashtu edhe në planin praktik të punës shkencore. Qëllimi themelor mbetet aftësimi i studentit për të realizuar hulumtime individuale, por edhe grupe akademike, si dhe krijimi i shkathtësive të nevojshme për hartimin adekuat të seminareve dhe punimit.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Deri në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje: - Të kuptojnë dhe përshkruajnë natyrën e hulumtimeve në Edukim; - Të jenë në gjendje të realizojnë hapat konkret në

	realizimin e një studimi themelor; - Të jenë në gjendje të hartojnë raporte të projekteve hulumtuese; - Të jenë në gjendje të hartojnë projekt propozime të ndryshme.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15/javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	3	5
Ushtrime në teren	4	2	4
Kollokfiime,seminare	3	3	12
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
<b>Totali</b>			<b>104</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Metodologjia e mësimdhënies për këtë kurs është e kombinuar midis ligjëratave të shkurta rreth temave të caktuara dhe pastaj me aktivitete përcjellëse që do të jenë të orientuara drejt temave konkrete,punet praktike ne teren që secili student do të zgjedh për temën e punimit empirik qe do te realizohet ne bashkepunim me profesorin e lendes.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijueshmëria në ligjerata                    5 pikë Kollokviumi                                        20 pikë Prezantimi me punim                            25 pikë Provimi përfundimtar                           50 pikë  <div style="text-align: right;">Gjithsej: 100 pikë</div>		
<b>Literatura</b>			

<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Metodologjia e hulumtimit, Ranjit Kumar, botimi i katërt, 2017</li> <li>- Metodot e hulumtimit, Bob Matheus, Liss Ross</li> <li>- Si bëhet një punim diplome, Umberto Eco - Si të shkruajmë një punim shkencor, Autor Bardhyl Musai</li> <li>- Metodologjia e hulumtimit Shkencore, Xheladin Murati, Shkup, 2010</li> </ul>
<b>Literatura shtesë:</b>	<i>Metodologjia e Punës Shkencore kerkimore</i> , dr. Ali Jakupi, Prishtinë, 2005
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<i>Tema: Çështje hulumtimi</i>
<i>Java e dytë:</i>	<i>Tema: Dijet, teoritë, paradigmat dhe këndvështrimet</i>
<i>Java e tretë:</i>	<i>Tema: Natyra e të dhënave</i>
<i>Java e katërt:</i>	<i>Pyetjet e hulumtimit, hipotezat dhe përkufizimet operative të hulumtimit</i>
<i>Java e pestë:</i>	<i>Hulumtimi si çështje etike dhe kulturore</i>
<i>Java e gjashtë:</i>	<i>Planifikimi i një projekti hulumtues</i>
<i>Java e shtatë:</i>	<i>Popullacioni dhe kampionimi</i>
<i>Java e tetë:</i>	<i>Test për vlerësimin e njohurive</i>
<i>Java e nëntë:</i>	<i>Mbledhja e të dhënave</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	<i>Pyetësoret dhe intervistat</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<i>Grupet e fokusit</i>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<i>Burimet parësore dhe dytësore të të dhënave në hulumtimet shoqërore</i>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<i>Analiza e të dhënave</i>
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	<i>Paraqitja e të dhënave dhe raportet</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<i>Të shkruarit për procesin e hulumtimit</i>

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

***Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UPZ-së***

- *Pritet që studenti ti përcjell me rregull ligjëratat dhe ushtrimet.*
- *Studentët duhet të mbajnë qetësi në sallë dhe të jenë të koncentruar në mësim.*
- *Secilit student i lejohet që të parashtojë pyetje apo të bëjë komente kur i jepet fjala;*
- *Gjatë kohës së ligjëratave të shkyçen telefonat celular*